




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
MINISTRI



Nr. 9057/prot.
1

Tiranë, më 31.12.2025

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARIT

Nr. 9057/, datë 31.12.2025
1

“MBI ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË “EKORR” SH.A”

Mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 135, 145, 168 e në vijim të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), ligjin nr.9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar), VKM nr.821, datë 30.12.2025 “Për një shtesë në vendimin nr.684, datë 06.11.2024 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e shoqërisë aksionare “Enti Kombëtar i Operimit Rrugor” sh.a”, ligjin nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025” (i ndryshuar), Statutin e shoqërisë, Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme nr.10012prot., datë 23.12.2024 “Për themelimin dhe miratimin e statutit të shoqërisë “Enti Kombëtar i Operimit Rrugor” sh.a, në cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë “EKORR” sh.a,

VENDOSA:

1. Zmadhimin e Kapitalit të shoqërisë “EKORR” sh.a në shumën prej 50,000,000 (pesëdhjetë milion) lekë.
2. Derdhja e kapitalit të shoqërisë me para do të kryhet nëpërmjet emetimit të 50,000 aksioneve të reja me vlerë nominale 1000 lekë për aksion, të cilat do të përbëjnë aksionet në kapitalin themeltar të shoqërisë.
3. Ngarkohet Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të kryejnë transaksionin financiar për derdhjen e kapitalit themeltar në vlerën 50,000,000 (pesëdhjetë milion) lekë, në favor të shoqërisë “EKORR” sh.a.
4. Ngarkohet Administratori i shoqërisë “EKORR” sh.a, për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në rregjistrer pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE
MINISTËR

Belinda Balluku

